



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes urgjente të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, mbajtur më 25.05.2017,
e cila filloi në orën 15:00.

Në mbledhje morën pjesë: Halim Halimi, kryesues i Kuvendit, këshilltarët e Kuvendit: Hazir Borovci (LDK), Agim Gashi, shef i GP-së (LDK), Naime Osmani (LDK), Hasime Krasniqi (LDK), Shefki Gashi (LDK), Shaip Hajrizi (LDK), Shefqet Sylejmani (LDK), Muhamet Nura (LDK), Mustafë Krasniqi (LDK), Vjollca Dibra - Ibrahimimi (LDK), Besa Rafuna (LDK), Ajnishahe Azemi (LDK), Hetem Kupina (LDK), Merita Surkishi (LDK), Fisnik Osmani (LDK), Qëndron Kastrati, shef i GP-së (LVV), Sylejman Pireva (LVV), Hatixhe Hoxha (LVV), Genc Sherifi (LVV), Teuta Krasniqi (LVV), Bardha Dida - Rogova (LVV), Hatixhe Latifi - Pupovci (LVV), Berat Lahu (LVV), Lirak Çelaj, shef i GP-së (PDK), Blerand Stavileci (PDK), Shaip Shabani (PDK), Lirie Avdiu (PDK), Muhamet Selmani (PDK), Laura Zherka (PDK), Egzona Podvorica (PDK), Mirlinda Sopi, shefe e GP-së (AKR), Sami Boroci (AKR), Remzi Pacolli (AKR), Sofije Bunjaku (AKR), Kimet Zeqa (AKR), Brahim Mehmetaj, shef i GP-së (AAK-LDD), Imer Rusinovci (AAK-LDD), Rita Begolli (AAK-LDD), Fadil Gashi (AAK-LDD), Feti Mehdiu, përfaqësues i subjektit politik (PD), Abetare Fazliu, përfaqësuese e subjektit politik (LB), Nenad Miladinoviqi, përfaqësues i subjektit politik (GIS), Visar Arifaj, përfaqësues i subjektit politik (PF) dhe Cuneyd Ustaibo, përfaqësues i subjektit politik (KDTP).

Munguan: Vlora Dumoshi (LDK), Flamur Shala (LDK), Ylli Hoxha (LVV), Sadri Ramabaja (LVV), Shemsi Veseli (PDK) dhe Abit Kastrati.

Të pranishëm ishin edhe përfaqësues të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësues të OJQ-ve, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike dhe përfaqësues të OSBE-së.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Halim Halimi**, kryesues, i cili e hapi diskutimin për rendin e ditës.

Agim Gashi shprehu shqetësimin, duke cekur se është e panatyrshme të diskutohet, kur as kryetari, as nënkryetari nuk marrin pjesë në seancë. Po ashtu, Ministria kërkesën, përkatësisht shkresën e ka dërguar me kohë dhe është ruajtur dita e parafundit si afat i fundit, dhe është krijuar situatë urgjente për trajtimin e kësaj pike të rendit të ditës.

Genc Sherifi tha se LVV-ja e përkrah miratimin e kësaj pike të rendit të ditës.

Lirak Çelaj shprehu pakënaqësi, duke theksuar se është e paarsyeshme mbajtja e kësaj mbledhjeje kaq të ngutshme, sa që nuk na jepet as rasti që ta analizojmë si duhet këtë material. Mbledhja është thirrur më pak se 24 orë përpara dhe nuk e di a ka të drejtë të thirret një mbledhje e tillë. Po ashtu, kjo pikë do të duhej fillimisht të shqyrtohej në KPF, pastaj të silllet në Kuvend.

Ai kërkoi nga Zyra ligjore që të citojë se kur mund të thirret një mbledhje e tillë.

Sami Boroci ceku se Grupi i këshilltarëve të AKR-së, me gjithë shqetësimin e marrjes së materialit me vonesë, komentet do t'i japë në pjesën e diskutimit.

Imer Rusinovci tha se në parim e mbështesim këtë rishikim të buxhetit, por si GP, në emër të AAK-së paraqesim një kërkesë, e cila sigurisht se do të shqyrtohet gjatë interpretimit të pikës së rendit të ditës. Kuvendi i Komunës para dy vjetëve ka marrë një vendim që të përkrahen sadopak zonat rurale të pjesës së Prishtinës, përkatësisht të fshatrave të Gollakut. Është fjala për 3 ferma të zonave të thella rurale, që e lidhin pjesën e Gollakut me atë të Podujevës. Është kërkesë e jona për këtë rrugë që të kihet parasysh pikërisht në këtë pikë të rendit të ditës.

Feti Mehdiu u shpreh i pajtimit, por përkundër vërejtjeve që u përmenden, kjo nguti na vë para njëfarë dileme se çka të bëjmë, por prapë më mirë është të punojmë kështu siç na ka ardhur, sesa ta shtyjmë më tutje.

Abetare Fazliu tha se LB përkundër vërejtjeve që u dhanë, e përkrah këtë vendim.

Visar Arifaj shprehu mendimin se është kohë e shkurtër për ta shqyrtuar këtë dokument. Për ta ditur se e përkrahim apo jo, na duhet një shpjegim nga ekzekutivi, se çka në fakt po ndryshon, se po e shohim që vijat buxhetore edhe shumat të cilat po merren, po kthehen te të njëjtat me shumata të njëjta.

Cuneyd Ustaibo e përkrahu propozimin.

Nenad Miladinoviqi e mbështeti propozimin.

Ardian Olluri dha sqarim, duke thënë se afatet dhe procedurat që zbatohen te mbledhjet e rregullta dhe te mbledhjet e jashtëzakonshme, nuk zbatohen te mbledhjet urgjente, pra te mbledhjet urgjente nuk zbatohen të njëjtat procedura. Në vitin 2015, rishikimi është bërë në Komunën e Prishtinës me mbledhje urgjente. Po ashtu, disa komuna edhe vitin e kaluar e kanë bërë rishikimin e buxhetit me mbledhje urgjente.

Kryesuesi kërkoi të dijë se sa i përmbushë kushtet që të jetë mbledhje urgjente, kur shkresën prej Ministrisë e kemi marrë më 03.05.2017, ndoshta kemi pasur kohë me e shqyrtuar edhe në ndonjërin prej mbledhjeve të rregullta ose të jashtëzakonshme. Jam i informuar për këtë shkresë dhe e kam parë të arsyeshme që të thirret mbledhja urgjente për rishikimin e buxhetit.

Shefki Gashi shprehu mendimin që rishikimi i buxhetit të diskutohet në një seancë tjetër.

Muhamet Selmani shfaqti dilemë, duke thënë se nëse e shohim vendimin për bartjen e buxhetit, thotë se buxheti merret ose nga kodet buxhetore edhe bartet, ose orientohet prapë, por nëse i shohim këto përshkrime, të gjitha janë të njëjta dhe nuk e di se ku është logjika e kësaj bartjeje. Po ashtu nëse shkojmë te buxheti i administratës, thuhet se merren mallra.

Berat Lahu shprehu mendimin se arsyetimi i dhënë nga disa asamblistë, ka qenë që Ministria është vonuar në dorëzimin e rishikimit të buxhetit, andaj besoj se e njëjta ka qenë edhe me Komunën e Prishtinës, nuk kanë pasur mundësi me e sjellë më herët, por në një mbledhje e cila është dashur të thirret si urgjente. Sa për pjesën e papërgjegjesisë nga ana e ekzekutivit, për mua janë të mjaftueshëm drejtorët këtu të cilët e përfaqësojnë ekzekutivin e Komunës dhe i mbrojnë linjat buxhetore për të cilat po bëhet rishikimi.

Adrian Olluri citoi nenin 7 të Udhëzimit administrativ, ku thuhet se kryesuesi dhe kryetari kanë të drejtë të thërrasin mbledhje urgjente të Kuvendit të Komunës. Në paragrafin e dytë thuhet se mbledhjet urgjente të Kuvendit të Komunës thirren në raste të fatkeqësive natyrore dhe rrethanave të tjera urgjente në komunë dhe, paragrafi i tretë, ku thuhet se procedurat për thirrjen e mbledhjes urgjente nuk zbatohen si në rastet e thirrjes së mbledhjeve të tjera të Kuvendit të Komunës.

Kryesuesi e hodhi në votim rendin e ditës.

Kryesuesi konstatoi se më 39 (tridhjetë e nëntë) vota për, 2 (dy) vota kundër (Agim Gashi, Hazir Borovci) dhe 2 (dy) abstenime, (Besa Rafuna, Muhamet Nura), u miratua ky

REND I DITËS:

1. Propozimvendimi për rishikimin e buxhetit për vitin 2017.

Kryesuesi hapi diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës.

Ismail Kokaj, drejtori i Drejtorisë së Financave, tha se arsyen pse duhet të mbahet kjo mbledhje e kemi shprehur përmes arsyetimit, të cilin e keni të bashkëngjitur pas pasusit të vendimit. Sa i përket pyetjes së parashtruar nga z. Selmani, ku gjithsej buxheti i propozuar për riorientimin është 1,232,040, pyeti pse është vlera e njëjtë. Vlera e njëjtë është sepse në paragrafin 1 dhe 2 kemi orientimin "mallra dhe shërbime" nuk mund t'i lëvizim në një pozicion tjetër, por duhet lënë në "mallra dhe shërbime".

Në tabelën që është material shtesë, shihet prej cilës vijë buxhetore, në cilën vijë buxhetore shkojnë. "Mallra dhe shërbime", 134 mijë euro delegohen prapë në "mallra dhe shërbime", mirëpo nëse hyjmë në detaje në tabelë, që e keni këtu, mund ta shpjegojmë secilën veç e veç, ku është paraparë që shpenzimi me qenë sa më i mirë. Arsyeja pse po bëhet ky rishikim i buxhetit, është që shpenzimet të jenë sa më efikase deri në fund të vitit. Ai e përmendi një lëshim teknik, i cili është faqe 7, e kemi te Drejtoria e Arsimit, është: "Shpenzime kapitale" 2.4.8, janë 50 mijë euro, të cilat shkojnë lart nga 2.4.9, ndërtimi i Qendrës për persona me nevoja të veçanta, është paraqitur 50 mijë euro, këtu ende nuk kemi filluar me këtë investim. Përderisa këto 50 mijë euro shkojnë lart dhe orientohet në 2.4.8, "renovimi dhe rindërtimi", këtë detaj desha ta shpjegoj, ishte te Drejtoria e Shëndetësisë.

Agim Gashi tha se ka shumë paqartësi në propozimin e ndryshimit të buxhetit. Në pikën 146.1, "reklammat dhe konkuret", si është e mundur t'i merret komplet buxheti Komisionit të konkurseve. Nëse kjo i merret, atëherë Komuna mbetet pa asnjë cent për shpalljen e konkurseve publike.

Neve po na ndodhë shpeshherë miratimi i projekteve të caktuara në bazë të planit buxhetor vjetor, po ndryshohet më vonë, ashtu si na është ndryshuar p.sh. "Qendra për nevoja të veçanta", iu ka ndryshuar emri dhe ka ardhur tash me një emër tjetër, këtu nuk është siç është në miratimin e buxhetit 2017.

Qëndron Kastrati tha se GP i VV-së e përkrah këtë propozim nga ekzekutivi. Këto janë projekte të cilat janë në proces e sipër, për shkaqe të ndryshme kanë vazhduar edhe këtë vit, për këtë arsye ne do ta përkrahim.

Muhamet Selmani theksoi se sipas Ligjit në fuqi mbi buxhetin e konsoliduar të Republikës së Kosovës, lejohet që bartja të bëhet nga kryetari i komunës deri në 5%, pa pasur nevojë që të aprovohet nga Kuvendi, nëse kalon mbi 15%, atëherë duhet të bëhet me pëlqimin e Kuvendit dhe Ministrisë së Financave, pastaj mbi 25%, shkohet në Kuvendin e Kosovës. Unë nuk e shoh të arsyeshme për një lëvizje me 2% të buxhetit, të thirret mbledhje kaq urgjente.

Sami Boroci tha se ne si grup në parim do ta mbështesim rishikimin e buxhetit.

Ai shtroi pyetje në adresë të Drejtorisë së Shëndetësisë, e cila ka të bëjë me ndërtimin e QKMF-së në lagjen "Vetërniku", se kur është planifikuar të ndërtohet dhe cila është adresa e saktë e kësaj qendre. Pyetje për drejtorin e Financave: Ne si grup ose si Kuvend i Komunës, a mund të propozojmë krijimin e një fondi emergjentë për bujqësi?

Feti Mehdiu sugjeroi që në faqen 7, aty ku shkruan "ndërtimi për persona me nevoja të veçanta", nuk është e nevojshme të futet në kllapa. Mendimi ynë është ose të numërohen të gjitha kategoritë e sëmundjeve, ose të mos figurojë asnjë.

Abetare Fazliu, sa i përket ndërtimit të rrjetit të kanalizimit në lagje të reja, pyeti se a kanë filluar ende, sepse atë pjesë i kemi në gjendje shumë të rëndë. Gjithashtu edhe për trajtimin e kafshëve endacake, është diskutuar më herët dhe është premtuar se do të bëhet një qendër ose një trajtim më i veçantë për ta, mirëpo nuk e di a ka filluar ende me u bërë. Gjithashtu rregullimi dhe rrethimi i varrezave të komunës nuk është duke u bërë në mënyrë të duhur. **Visar Arifaj**, lidhur me arsyetimin të cilin e kemi marrë dhe me tabelat që na janë paraqitur, tha se unë nuk po e kuptoj në fakt se çka jemi duke votuar. Shumica, mos të them krejt linjat që po ndahen, sidomos prej subvencioneve, po e shohim vetëm shumën që po shkon, po nuk po e dimë ku. Kështu që nëse specifikisht nuk ka ndonjë arsye se kujt po ia drejtojmë këto mjete të bartura, atëherë kështu si është nuk do ta votoj.

Shefki Gashi ceku se para një viti kur është bërë rishikimi i buxhetit, janë ndarë mjetet për planifikimin e sistemit të ujit për fshatrat përreth Prishtinës, ku nuk kanë qasje 26 fshatra në rrjetin e ujit teknik. Kemi ndarë 50 mijë euro atëherë, tash propozoj që nëse duhet më shumë me i ndarë edhe 50 mijë euro të tjera, le të bëhet projekti dhe ne e hulumtojmë mundësinë për dërgimin e rrjetit të ujësjes, duke filluar prej fshatrave: Grashicë, Mramur, Busi, Suteskë, Slivovë, Mukatë, Llajshevc, Marevc, Koliq, Keqekollë, Dabishec, Hajkobillë, Glllogovicë, Rimanishtë.

Imer Rusinovci, në emër të banorëve të një pjese të Gollakut, e falënderoi Kuvendin e Komunës që para dy vjetëve e mori një vendim të qëlluar dhe e bëri edhe një zonë të thellë rurale me rrugë të asfaltuara deri te shkolla e fshatit Nishec. Edhe atëherë kërkesa ishte që ajo zonë e thellë rurale të lidhet sado pak me komunën e Podujevës. Tri nga fermat aktuale, që janë me një aktivitet të kufizuar, janë në kushte shumë të rënda në mungesë të plasmanit të produkteve, prandaj unë e ftoj këtë asamble ta përkrahë këtë kërkesë të atyre pak fermerëve që kanë mbetur në atë pjesë.

Kimet Zeqa theksoi se forumi është organizatë ombrellë i të gjitha shoqatave që përfaqësojnë personat me aftësi të kufizuara. Këtë mbështetje forumi e ka paraqitur edhe para Kabinetit të Kryetarit. Forumi fuqishëm përkrah iniciativën e Shoqatës së Personave me Syndrom Down dhe Autizëm për ndërtimin e qendrës që i ofron këto shërbime.

Berat Lahu shprehu përkrahje për këtë propozim për rishikim të buxhetit. Sa i përket rrjetit të ujësjes, ne jemi zotuar për të pasur ujë 24 orë në qytetin e Prishtinës dhe e kemi realizuar brenda mandatit, ndërsa sa i përket rrjetit të ujësjes në fshatrat e komunës së Prishtinës, do ta bëjmë së shpejti.

Agim Gashi tha se është shumë me rëndësi të shpallet tenderi për hartimin e projektit për furnizim me ujë pjesë-pjesë, sepse e dimë që 24 fshatra nuk mund të furnizohen dhe nuk mund të ndërtohet rrjeti i ujësjes brenda një viti buxhetor.

Fadil Gashi tha se është shumë e nevojshme që këto fshatra të furnizohen me ujë.

Blerand Stavileci bëri të ditur se ky është projekt prej 35 milionë eurosh, po flas me kompetencë se janë të dhëna të sakta, prej të cilave me pesë milionë ka kontribuar Qeveria, me pesë milionë Komuna e Prishtinës, 20 milionë kredi të marra nga KRU "Prishtina" dhe 5 milionë grante nga Komisioni Evropian. Komuna e Prishtinës është e vetmja nga këto që u përmendën që nuk i ka shlyer edhe 2.5 milionë euro.

Shaip Hajrizi shprehu shqetësim për faktin se mbi 20 fshatra nuk kanë ujë, por edhe një pjesë e lagjes "Kodra e Trimave" nuk ka ujë 24 orë pa ndërprerë.

Ferat Makolli, drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë, dha sqarim lidhur me fushën që e përfaqëson, duke paraqitur këto të dhëna: vaksinimi për gjedhe dhe dele është 25 mijë euro, ngritja e kapaciteteve për ruajtjen e pemëve dhe perimeve është 150 mijë euro, përkrahja e bletarëve, pagesa direkte është 50 mijë euro, dhe përkrahja e fermerëve për ujitjen e kulturave bujqësore, pemëve dhe perimeve është 20 mijë euro, përshtatshmëria e tokës për prodhimtari bujqësore është 25 mijë euro dhe përkrahja bujqësore organike 80 mijë euro, përkrahja për ngritjen e kapaciteteve të reja mjedër është 36 mijë euro dhe përkrahja e prodhimtarisë së qumështit është 100 mijë euro, kurse materialin që ju e keni marr është kopje e vitit 2015.

Ismail Kokaj, drejtor i Drejtorisë së Financave, tha se arsyeja pse u përmend 5%, ka qenë më herët kur është folur për komplet kategorinë, tash i kemi nënkategoritë dhe çdo shpenzim specifikohet në nënkode.

Momentin që nuk mundemi me i shfrytëzuar të gjitha që janë në nënkode, atëherë kemi me pasur tepricë të buxhetit, për atë edhe e kemi sjellë në rishikim buxhetin. Te fabrika e ujit, është votuar në bartjen e buxhetit 2 milionë e 450 mijë euro për me iu bërë pagesa atyre që cekët, nuk është në këtë buxhet të vitit 2017, pra në këtë vit është bërë bartja e mjeteve të vitit 2016.

Lirie Avdiu bëri pyetje lidhur me atë që e tha drejtori, pra me kodet dhe nënkodet. Këtu kodet buxhetore sa për qind të tyre mund të rishikohen nga kryetari pa shqyrtim dhe aprovim të Kuvendit?

Mirlinda Sopi kërkoi sqarim nga drejtori i Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, se a është kjo tabelë e dakorduar, në mënyrë që të mos e votojmë këtë buxhet me dilema.

Ferat Makolli u shpreh se ne jemi konsultuar me drejtorin e Drejtorisë së Financave dhe gjithçka është në rregull.

Imer Rusinovci kërkoi të dijë se a do të jetë ajo Qendër me nevoja të veçanta, a do t'i përfshijë të gjitha kategoritë, apo vetëm për peronat me Syndrom Down dhe Autizëm.

Ardian Olluri tha se në seancën kur është miratuar buxheti i vitit 2017, është diskutuar, ka pas propozime për çështje tjera. Kryetari atë ditë ka propozuar që pjesa në kllapa me u larguar. Në fund të seancës, kryesuesi ka propozuar që shifat e GP të takohen para se të bëhet votimi, pra të diskutojnë se cilat ndryshime po i qesim për miratim.

Nuk ka pas dakordim për këtë propozim. Kryesuesi e hodhi në votim buxhetin pa e qitur paraprakisht asnjë propozim për ndryshim. Pra, Kuvendi e ka votuar buxhetin pa asnjë ndryshim. Është e vërtetë që në ekstrakt është shënuar diçka që në fakt nuk është konstatuar prej kryesuesit. Edhe pasi që është ngritur në seancën e kaluar kjo çështje, e kam shikuar videon prapë dhe askund nuk dëgjohet kryesuesi duke përmendur çfarëdo ndryshimi në fund kur bëhet votimi.

Lirak Çelaj tha se unë nuk dua të votoj diçka që e kemi votuar më herët.

Kryesuesi u shpreh se do të na përsëritet e njëjta nëse nuk e qesim kështu, shkon me këtë emër "Qendra me Syndrom Down dhe Autizëm".

Kryesuesi e hodhi në votim Propozimvendimin për rishikimin e buxhetit për vitin 2017, ashtu siç ishte paraqitur, pra siç është marrë vendimi në mbledhjen e kaluar, për ndërtimin e Qendrës për rehabilitimin e personave me aftësi të kufizuara.

Kryesuesi konstatoi se më 23 (njëzet e tri) vota për, 11 (njëmbëdhjetë) vota kundër, (Agim Gashi, Ajnishahe Azemi, Blerand Stavileci, Egzona Podvorica, Halim Halimi, Laura Zherka, Lirak Çelaj, Lirie Avdiu, Muhamet Nura, Muhamet Selmani, Naime Osmani) dhe 4 (katër) abstenime, (Hasime Krasniqi, Merita Surkishi, Mustafë Krasniqi, Visar Arifaj), u miratua Vendimi për rishikimin e buxhetit të Komunës së Prishtinës për vitin 2017.

Mbledhja përfundoi në orën 16:30.

Procesmbajtësja
Luljeta Selimi

Kryesuesi i Kuvendit
Halim Halimi. jur. i dip.